



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik

UDHËZIM
PËR DOKUMENTACIONIN E REGJISTRIMIT TË
ORGANIZMIT TË TESTIMIT DHE KONFIRMIMIT



Udhëzim nr.2
Versioni 2.1
Buletini 2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

UDHËZIM NR. 2

PËR DOKUMENTACIONIN E REGJISTRIMIT TË ORGANIZMIT TË TESTIMIT
DHE KONFIRMIMIT

Në mbështetje të Ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, Ligjit nr. 107/2015, datë 1.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 69, datë 27.1.2016 “Për miratimin e rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik,

UDHËZON:

Të gjithë personat fizikë ose juridikë, që duan të regjistrohen pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, (AKCE) për të përfituar statusin si Organizëm Testimi dhe Konfirmimi, duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Dokument lëshuar nga Gjykata që vërteton se, personi nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë nga veprat e parashikuara në rregulloren “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, pjesa III “Kushtet ligjore, teknike, profesionale dhe financiare”, pika 4 “Besueshmëria ligjore”, lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e aplikimit;
2. Ekstrakt me të dhënat e subjektit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për regjistrimin e biznesit, (statusi aktiv), lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e aplikimit;
3. Certifikata për njohuritë e nevojshme lidhur me procesin e lëshimit të certifikatave të kualifikuara dhe për pajisjet që përdoren për këtë proces;
4. Deklaratë me shkrim, që nuk ka konflikt interesi dhe siguron transparencë dhe paanësi në vlerësimin që do të kryejë gjatë auditimit të OKSHB-ve të regjistruara;
5. Deklaratë me shkrim, se disponon personel të kualifikuar dhe mjete të nevojshme në lidhje me fushën apo aktivitetin e specifik teknik, që do të auditojë.
6. Deklaratë me shkrim, për ruajtjen e konfidencialitetit mbi informacionin që do të marrë gjatë ushtrimit të detyrës dhe gatishmërinë për ta vënë në dispozicion të Autoritetit, kurdoherë që ndërpret aktivitetin;

7. Deklaratë me shkrim, që garanton raportimin pranë Autoritetit për konfirmimin e përmbushjes së kërkesave ligjore, financiare dhe teknike që duhet të plotësojë Ofruesi i Kualifikuar i Shërbimit të Besuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 8.2.2016